



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.54

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr.35, datë 11.5.2006	Për miratimin e përbërjes së Komisionit Hetimor “Për shkarkimet në administratën publike”..... 1551
Vendim i Kuvendit nr.36, datë 11.5.2006	Për miratimin e përbërjes së Komisionit Hetimor “Për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për eliminimin e kësaj situatë monopol”..... 1551
Vendim i Kuvendit nr.37, datë 11.5.2006	Për disa ndryshime në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit..... 1552
Rezolutë e Kuvendit datë 15.5.2006	Për raportin e Këshillit Drejtues për veprimtarinë vjetore të RTSH-së për vitin 2005..... 1552
Vendim i KM nr.291, datë 17.5.2006	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunimin në fushën e postave dhe të komunikimit elektronik..... 1553
Vendim i KM nr.292, datë 17.5.2006	Për dhënien në përdorim Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të disa mjediseve, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes..... 1557
Vendim i KM nr.293, datë 17.5.2006	Për shpalljen “Kombëtar” të Muzeut të Pavarësisë, Vlorë dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të tij, nga bashkia e Vlorës në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe

Sporteve.....	1560
...	

Udhëzim i MMPAU
nr.4, datë 8.5.2006

Për pajisjen me “Certifikatë origjine për eksport” për materialet drusore ose të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore, të përpunuara ose të papërpunuara, bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, specieve të faunës së egër, me origjinë nga fondi pyjor, kullosor dhe i gjuetisë në Republikën e Shqipërisë.....	1560
---	------

Vendim i GJL
nr.5, datë 3.3.2006

Me objekt anulimin e aktit administrativ, vendimi nr.51, datë 6.09.2005 i Këshillit të Bashkisë Korçë.....	1568
--	------

VENDIM
Nr.35, datë 11.5.2006

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR “PËR SHKARKIMET NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e grupeve parlamentare,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e Komisionit Hetimor “Për shkarkimet në administratën publike”, si më poshtë:

1.Blendi Klosi	Kryetar	PS
2.Edmond Spaho	Zëvendëskryetar	PD
3.Gilman Bakalli	anëtar	PD
4.Pal Dajçi	“	PD
5.Rexhep Uka	“	PD
6.Lajla Përnaska	“	PR
7.Nikolla Neranxi	“	PAA
8.Besnik Dervishi	“	PS
9.Marko Bello	“	PS
10.Angjelina Kola	“	PSD
11.Pëllumb Xhufi	“	LSI

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.36, datë 11.5.2006

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT HETIMOR “PËR HETIMIN E TREGUT MONOPOL TË TELEFONISË CELULARE DHE PËRGATITJEN E REKOMANDIMEVE PËR ELIMINIMIN E KËSAJ SITUATE MONOPOL”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e grupeve parlamentare,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e Komisioni Hetimor “Për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për eliminimin e kësaj situatë monopol” si më poshtë:

1. Neritan Ceka	Kryetar	PAD
2. Ilir Bano	Zëvendëskryetar	PD
3. Aleksandër Biberaj	anëtar	PD
4. Ramiz Çobaj	“	PD

5. Genc Juka	“	PD
6. Artur Hasanbelliu	“	PR
7. Petro Koçi	“	PS
8. Taulant Balla	“	PS
9. Shpëtim Idrizi	“	PS
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.		

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.37, datë 11.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Ylli Bufi zgjidhet Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Deputeti Arben Malaj zgjidhet zëvendëskryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Deputeti Durim Hushi zgjidhet anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

REZOLUTË

PËR RAPORTIN E KËSHILLIT DREJTUES PËR VEPRIMTARINË VJETORE
TË RTSH-SË PËR VITIN 2005

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi u njoh me Raportin e Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2005, vëren se:

Në rezolutën që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar për veprimtarinë e RTSH-së një vit më parë, është synuar që RTSH-ja të marrë atributet e një institucioni publik të rëndësishëm mediatik, duke u shndërruar realisht në një institucion që i nënshtrohet vetëm detyrimit të ligjit dhe jo trysnive politike.

Në raportin e paraqitur nga Këshilli Drejtues i RTSH-së pranohen disa arritje, si në drejtim të strukturës së programeve, ashtu edhe për sa i përket administrimit të buxhetit, për të cilin pretendohet se është i pamjaftueshëm për mirëfunksionimin e këtij institucioni dhe e dobëson atë në konkurrencën me operatorët privatë.

Nga raporti evidentohet, gjithashtu, se ende nuk është arritur që RTSH-ja të jetë një operator publik dhe në shërbim të publikut. RTSH-ja nuk shkëputet kollaj nga kontrolli politik.

Sikurse rezulton nga Raporti i Këshillit Drejtues, RTSH-ja ka nevojë për reformë të thellë si në drejtim të strukturave programore, ashtu edhe në përmirësimin e funksionimit të tij në shërbim të publikut. Prania e publikut është e vakët, ndërsa drejtuesit ekzekutivë shpeshherë shpërfillin vendimet e Këshillit, duke krijuar kosto për mbarëvajtjen e këtij institucioni të rëndësishëm për informimin dhe edukimin e publikut të gjerë.

Raporti i Këshillit Drejtues të RTSH-së pretendon se gjatë periudhës 2005-2006 Këshilli Drejtues është përpjekur të zbatojë ligjin dhe detyrimet që rrjedhin prej tij, si dhe ka evidentuar disa nga problemet

kryesore që lidhen me marrëdhëniet Këshill Drejtues-Drejtori e Përgjithshme. Raporti nxjerr në pah se me gjithë përpjekjet e Këshillit, marrëdhëniet e tij me strukturat ekzekutive të RTSH-së kanë qenë shpeshherë të tensionuara dhe me probleme.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë.

Raporti i paraqitur nga Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk u referohet vërejtjeve dhe problemeve që ka evidentuar Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas verifikimit të shpenzimeve të fondeve publike, por paraqet thjesht një pasqyrë, sipas së cilës parashikimet në buxhet dhe në buxhetin faktik janë realizuar pothuajse 100 për qind. Këtu duhet përmendur fakti se RTSH-ja nuk ka mundur të arkëtojë borxhin prej 127 856 480 lekësh që konkurrentët privatë i kanë këtij institucioni. Probleme ka pasur edhe për sa i përket çështjeve të pagave dhe shpërblimeve, kryesisht për disa nga anëtarët e stafit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Ende nuk është realizuar detyra e lënë për reformimin e strukturës së pagave dhe përpilimin e piramidës së pagave të miratuara nga Këshilli Drejtues.

Në gjykojmë se më e rëndësishme në punën e Këshillit Drejtues, siç tregon edhe raporti i vitit të kaluar për veprimtarinë e RTSH-së, nuk është numri i mbledhjeve të realizuara, por realizimi i detyrave ligjore dhe përlogaritja e arritjeve të realizuara në krahasim me veprimtarinë e vitit të kaluar. Në këtë këndvështrim, Kuvendi mendon se Këshilli Drejtues nuk ka zbatuar detyrimet ligjore dhe nuk i ka realizuar objektivat e tij.

Kuvendi, që vitin e kaluar, në Rezolutën e miratuar për veprimtarinë e RTSH-së vlerëson se “Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk ka përmbushur detyrimet që i ngarkon ligji dhe për të cilat është votuar nga ky Kuvend”. Pas një viti vërejmë se nuk ka ndodhur asgjë. Mbi këtë bazë kërkohet shkarkimi i këtij Këshilli Drejtues dhe ngritja e Këshillit të ri mbi bazën e ligjit të ri të miratuar.

Tiranë, më 15.5.2006

VENDIM

Nr.291, datë 17.5.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E POSTAVE DHE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunimin në fushën e postave dhe të komunikimit elektronik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E POSTAVE DHE KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Greqisë, tani e tutje të referuara "Palët",

me dëshirën për të zhvilluar marrëdhëniet bilaterale, midis Republikës Greke dhe Republikës Shqiptare,

me të njëjtën pikëpamje, që zhvillimi i komunikimeve elektronike është një faktor mjaft i rëndësishëm për të çuar përpara tregtinë dhe shkëmbimet teknike, ashtu si dhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të të dy vendeve,

duke konfirmuar nevojën e një bashkëveprimi të ndërsjellë për zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të komunikimit elektronik të deritanishëm midis dy vendeve,

duke theksuar interesin e përbashkët në vendosjen e një bashkëpunimi më të afërt në fushën e postave dhe komunikimeve elektronike, bazuar në kushte të favorshme dhe të barabarta dhe në traditat e fqinjësisë së mirë,

duke pranuar që shumë shërbime të reja të komunikimit elektronik bazohen në përdorimin e duhur të spektrit të radiofrekuencave dhe të orbitës gjeostacionare satelitore, si dhe të orbitave të tjera satelitore,

duke pasur parasysh se në zbatimin e neneve të mëposhtme të Marrëveshjes, Republika Greke duhet të respektojë detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Europian,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Palët, bazuar në barazi, reciprocitet dhe në ndihmën e ndërsjellë, duhet të ndjekin një politikë për sigurimin dhe zhvillimin e shërbimeve të komunikimit dhe postare midis dy vendeve, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në secilin prej vendeve: detyrimet reciprocikisht të zbatueshme sipas Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikimit (ITU), Bashkimit Universal Postar (UPU), Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO) dhe instrumenteve ligjore të vendosura prej tyre dhe kushtet e Marrëveshjes në fjalë.

Çështjet që nuk janë të rregulluara nga kjo Marrëveshje, nga detyrimet reciprocikisht të zbatueshme të Marrëveshjeve të referuara më sipër, ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare të cilat janë të lidhura me Palët, duhet të zgjidhen nga Marrëveshje të veçanta, në përputhje me legjislacionet e secilit prej vendeve.

Çështjet e lidhura me sigurimin dhe veprimet e shërbimeve të komunikimit elektronik dhe postar, të cilat nuk janë të siguruar nga kjo Marrëveshje, do të rregullohen nga klauzolat e detyrimeve reciprocikisht të zbatueshme sipas UPU, ITU, WTO dhe instrumenteve ligjore të vendosura prej tyre.

Neni 2

Palët duhet të nxisin takimet midis qeverive të tyre, institucioneve publike, strukturave private, instituteve kërkimore, korporatave, organizatave të tjera të lidhura me to dhe specialistëve për:

a) çështje teknike dhe shkencore të lidhura me aktivitetet e bashkëpunimit në fushat e postave dhe komunikimeve elektronike;

b) të zgjidhur problemet që mund të lindin në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes;

c) të zbatuar projekte të përbashkëta.

Palët në fjalë mund të vendosin duke zbatuar programe, të cilat do të sigurojnë detajet e veprimtarive të bashkëpunimit, të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 3

Palët duhet të lehtësojnë transitin përmes territoreve të tyre të të gjitha llojeve të shërbimeve të komunikimit elektronik dhe objekteve postare, në kushte më të favorshme për të dyja palët.

Neni 4

1. Palët duhet të bien dakord për të shkëmbyer drejtpërdrejt postën ajrore, postën tokësore dhe shërbime të tjera, midis të tjerave:

a) Objektet e postës së letrave duke përfshirë letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, literaturat për të verbërit dhe paketat e vogla;

b) Paketat e zakonshme;

c) Shërbimin ekspres (EMS) dhe shërbimin elektronik postar.

2. Palët mund të përfitojnë shërbime përkatëse shtesë, nëpërmjet konsultimeve në korrespondencë.

Neni 5

Palët duhet të informojnë njëra-tjetrën në mënyrë sistematike për kufizimet lidhur me kushtet e postimit dhe lëvrimin, si dhe përmbajtjen e objekteve postare, bazuar në rregulloret e brendshme.

Neni 6

Palët duhet të përpiqen për të marrë masat e nevojshme, nëse do të rezultojë nevoja për përmirësimin e metodave dhe formave për shkëmbimin e postës, në mënyrë që të lehtësojnë transportin e postës dhe të forcojë sigurinë e saj.

Neni 7

Palët duhet të përgjigjen për humbjet, vjedhjet ose dëmtimet e objekteve të postës së letrave të regjistruara dhe të kolipostave, në të gjitha rastet, përveç forcës madhore.

Shuma e kompensimit të dëmit dhe masa e përgjegjësisë do të vendosen në bazë të kushteve të Konventës dhe të Marrëveshjes për Paketat Postare të UPU, në fuqi.

Neni 8

Palët duhet të përkrahin zhvillimin e bashkëveprimit në fushën e filatelistë, duke përfshirë dhe organizimin e ekspozitave të filatelistë.

Neni 9

Palët duhet të përpiqen të përkrahin:

a) krijimin e rrjeteve të komunikimit elektronik midis të dy vendeve, mbi bazën e aksesit të hapur të teknologjisë moderne dhe integrimin e tyre në rrjetin e komunikimeve elektronike mbarëbotërore.

b) përdorimin e telefonisë celulare, sistemeve satelitore dhe linjat e komunikimit fibra-optik, si pjesë e së ardhmes së infrastrukturës së informacionit mbarëbotëror.

Si përfundim, bashkëpunimi bilateral dhe projektet ndërkombëtare mund të zbatohen në bazë të marrëveshjeve të veçanta të lidhura midis enteve të lidhura me to, nën juridiksionin e secilës Palë.

Neni 10

Palët duhet të koordinojnë në strukturat nën autoritetin e tyre, përdorimin e frekuencave nga shërbimet radio, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre të brendshme, si dhe Kushtetutën e ITU-së, Konventën dhe rregulloret administrative. Një koordinim i tillë mund të arrihet nga shkëmbimi i korrespondencës ose nga nënshkrimi i marrëveshjeve të veçanta.

Neni 11

Palët, në përputhje me nevojat dhe burimet ekzistuese në vendet e tyre, bien dakord të përdorin institucionet akademike dhe shkencore në fushën e komunikimeve elektronike, me qëllim zhvillimin e avantazheve të ndërsjella të bashkëpunimit bilateral.

Lidhur me fushat kërkimore dhe me trajtimin e specialistëve në këtë fushë, Palët duhet të rekomandojnë dhe mbështesin bashkëpunimin direkt dhe bashkëveprimin midis enteve të specializuara në vendet e tyre.

Tarifat dhe shpenzimet për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe postare duhet të vendosen në përputhje me klauzolat e Konventës dhe Marrëveshjes për Kolipostat Postare të UPU-së, dhe Konventës, rregulloreve administrative dhe sipas rekomandimeve përkatëse të ITU-së.

Neni 12

Palët duhet të bashkëveprojnë përmes:

- a) shkëmbimit të informacionit dhe dokumentacionit;
- b) konsultimeve bilaterale;
- c) misionëve të ekspertëve dhe krijimin e grupeve të punës;
- d) shkëmbimit të specialistëve;
- e) programeve të trajnimit;
- f) formave të tjera të bashkëveprimit.

Neni 13

Palët mund të bëjnë propozim për një bashkëveprim më të ngushtë dhe për një koordinim të mëtejshëm në çështje specifike në përputhje me këtë Marrëveshje. Për këtë qëllim, kur është e përshtatshme dhe pas një miratimi të përbashkët, kontratat mund të firmosen midis enteve respektive të telekomunikimit, të përcaktuara *inter alia*, qëllimeve, projekteve të veprimit, periudhave kohore, departamenteve dhe personave përgjegjës, për përmbushjem me sukses të Marrëveshjes dhe kontratave.

Palët kur është e nevojshme duhet të konsultohen me njëra-tjetrën përmes korrespondencës për lehtësimin më tej të punës, drejtimit dhe rregullimit të tarifave, duke marrë në konsideratë situatën aktuale të punës së shërbimeve të komunikimit elektronik dhe postar, në të dy vendet.

Neni 14

Çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve në zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet me anë të negociatave dhe konsultimeve.

Neni 15

Marrëveshja në fjalë nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e Palëve, që burojnë nga marrëveshje ndërkombëtare me shtete të treta ose organizata ndërkombëtare.

Neni 16

Autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes në fjalë do të jenë:

- Në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
- Në Republikën Greke, Ministria e Transportit dhe Komunikacionit.

Në rast të ndonjë ndryshimi lidhur me këto autoritete kompetente, Palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur.

Neni 17

Asnjë informacion i përfshirë në këtë Marrëveshje nuk duhet t'u komunikohet Palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të Palës, nga e cila buron ky informacion.

Neni 18

Kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje dhe të gjitha aktivitetet e ndërmarra në përputhje me këtë Marrëveshje do të jenë objekt interpretimi i ligjeve dhe rregulloreve respektive të Palëve, duke pasur parasysh që në zbatimin e saj Republika e Greqisë duhet të respektojë detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Europian.

Neni 19

Çdo Palë duhet të përballojë shpenzimet e veta, të cilat rezultojnë nga zbatimi i sipërmarrjeve të saj konform kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur është vendosur ndryshe me shkrim midis Palëve.

Neni 20

Marrëveshja mund të modifikohet pas miratimit të përbashkët me shkrim të Palëve.

Çdo ndryshim i Marrëveshjes do të hyjë në fuqi në përputhje me të njëjta procedura, si dhe hyrja në fuqi e Marrëveshjes (neni 22).

Neni 21

Korrespondenca midis Palëve, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të mbahet në gjuhën angleze. Gjuha e korrespondencës midis enteve të tjera mund të vendoset me Marrëveshje të përbashkëta midis tyre.

Neni 22

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e notës së dytë diplomatike, me të cilën Palët njoftojnë njëra-tjetrën, mbi përfundimin e procedurave të brendshme përkatëse.

Marrëveshja do të jetë e vlefshme për një periudhë kohore të pacaktuar dhe do të humbë fuqinë gjashtë (6) muaj nga data në të cilën njëra nga Palët do të njoftojë tjetrën me shkrim, lidhur me qëllimin e saj për zgjidhjen e Marrëveshjes.

Bërë në Tiranë, më 6 prill 2006, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, greke dhe angleze, të tre tekstet njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshje në interpretim, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

VENDIM

Nr.292, datë 17.5.2006

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AVIACIONIT CIVIL TË DISA MJEDISEVE, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, pika 4, e 10 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2002 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, për një afat 10-vjeçar, të dy mjediseve, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) një sipërfaqe toke prej 600 m², pjesë e pronës me nr.223, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) një sipërfaqe toke prej 600 m², pjesë e pronës me nr.805, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil të lidhin një marrëveshje të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PORTO ROMANO SITE PLOT Scale 1:1 000

TOPOGRAPHIC MAP OF LOCATION AREA Excerpt from K-34-87-D-3 Scale



Block-mark Coordinates

Block	North	East	Zone
1001	4300000.00	4300000.00	1001
1002	4300000.00	4300000.00	1002
1003	4300000.00	4300000.00	1003

NATA RADAR SITE	
CONCEPTUAL PLAN	1001
GENERAL SITE LAYOUT	1002
PORTO ROMANO	1003

LOCKHEED MARTIN	
GENERAL SITE LAYOUT	1001
PORTO ROMANO	1002
PORTO ROMANO	1003

VENDIM
Nr.293, datë 17.5.2006

**PËR SHPALLJEN “KOMBËTAR” TË MUZEUT TË PAVARËSISË, VLORE DHE PËR
NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË TIJ, NGA BASHKIA E
VLORES NË MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”, të shkronjës “c”, të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 8 e 10 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Kombëtar” të Muzeut të Pavarësisë, në Vlorë, si person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Mjediset e Muzeut të Pavarësisë dhe inventari i mjeteve kryesore të kalojnë në përgjegjësi administrimi, nga bashkia e Vlorës te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Fondi për shpenzimet e pagave për punonjësit e Muzeut të Pavarësisë, të cilët do të përfshihen brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve buxhetorë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe shpenzimet e tjera të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për këtë ministri.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe bashkia e Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.4, datë 8.5 2006

**PËR PAJISJEN ME “CERTIFIKATË ORIGJINE PËR EKSPORT”
PËR MATERIALET DRUSORE OSE TË PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE E JO
PYJORE, TË PËRPUNUARA OSE TË PAPËRPUNUARA, BIMËVE MJEKËSORE,
ETEROVAJORE E TANIFERE NATYRORE, SPECIEVE TË FAUNËS SË EGËR, ME
ORIGJINË NGA FONDI PYJOR, KULLOSOR DHE I GJUE TISË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”,

UDHËZOJ:

1. Personat juridikë dhe fizikë, vendas apo të huaj, që kanë për destinacion eksportin e “Produkteve të prodhuara, të vjela apo të grumbulluara në fondin pyjor, kulllosor dhe në fondin kombëtar të bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore, të përpunuara ose të papërpunuara”, pajisen me certifikatë origjine për eksport, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Me certifikatë origjine për eksport, shoqërohet edhe eksportimi i “Specieve të faunës së egër, të gjuajtura në fondin e gjuetisë të Republikës së Shqipërisë”, konform ligjit nr.7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetisë”, i ndryshuar, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. “Certifikatat e origjinës për eksport”, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, lëshohen nga Drejtoritë e Shërbimit Pyjor, që kanë në administrim fondin pyjor nga i cili janë marrë produktet që kërkohen të eksportohen.

4. Për llojet e specieve të florës dhe faunës, të deklaruara në mbrojtje, sipas kërkesave të Konventës “Për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër”, si dhe për bimët e listuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.804, datë 24.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen nën mbrojtje”, certifikata e eksportit lëshohet nga Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës, duke plotësuar certifikatën tip të Konventës, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Për marrjen e certifikatës së origjinës për eksport të produkteve të përcaktuara në pikën 1 të udhëzimit, subjekti fizik apo juridik, paraqet kërkesën me shkrim në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për një lloj prodhimi dhe për çdo kontingjent të kontraktuar me parë me të.

6. Kërkesa për pajisje me certifikatë origjine për eksport, bëhet edhe nga çdo subjekt tjetër, i cili ka lidhur një kontratë shitblerje me subjektin kontraktor me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, pasi të ketë depozituar në këtë drejtori, një kopje të kësaj kontrate, sipas llojit dhe sasisë së blerë.

7. Për pajisjen me certifikatë origjine për eksport, për speciet e faunës së egër, të përcaktuar në pikën 2 të udhëzimit, kërkesa shoqërohet me:

- a) licencën e gjuetisë turistike dhe sportive;
- b) kontratën e lidhur me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor;
- c) autorizimin e gjuetisë së dhënë nga po ajo drejtori ku ata kryejnë gjuetinë.

Në rastin kur subjekti i autorizuar për gjueti, përbëhet nga disa gjahtarë të huaj, kërkesa për pajisjen me certifikatë origjine eksporti të gjahut të zënë prej tyre, bëhet nga përfaqësuesi i autorizuar me shkrim nga gjahtarët e grupit. Autorizimi dorëzohet së bashku me kërkesën për pajisjen me certifikatë.

8. Brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për pajisje me certifikatë eksporti, subjekti bën rakordimet e nevojshme me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor për sasinë e kontraktuar dhe për sasinë që do të eksportohet. Për eksportin e produkteve që ndryshojnë vëllimin e tyre gjatë përpunimit deri në momentin e eksportimit, sasia rakordohet duke llogaritur vëllimin e njomë ose bruto të kontingjentit për eksport, mbi bazën e koeficientëve teknikë, të hartuar nga Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave. Në fund të këtij afati, brenda 5 ditëve, lëshohet certifikata e origjinës për eksportin e llojit dhe sasisë së kërkuar.

9. Drejtoria e Shërbimit Pyjor jep vetëm një certifikatë për çdo autorizim dhe vetëm për sasinë e gjahut të shënuar në autorizimin përkatës, pavarësisht nga numri i personave që kanë gjuajtur.

10. Në rastin kur grupi i gjuetarëve të huaj, për arsye të largimit nga pika të ndryshme doganore, ndahet në disa nëngrupe, certifikata e eksportit jepet për çdo nëngrup, me sasinë respektive të gjahut të vrarë, por brenda sasisë totale që përmban autorizimi i lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastet kur secili prej gjuetarëve kërkon certifikatë origjine eksporti vetiake.

11. Certifikata e origjinës për eksport është pjesë e gjithë dokumentacionit që paraqitet pranë organeve doganore, mungesa e së cilës nuk lejon eksportin e produktit përkatës.

Administrimi, plotësimi dhe evidentimi i certifikateve

1. Certifikatat e origjinës për eksport botohen në blloqe të veçanta sipas llojit; duke u vlerësuar si letra sigurie, me numër serie unik, format standard, me letër që të peshojë më pak 25gr/m², me tre ngjyra të ndryshme e të pafalsifikueshme.

2. Blloqet administrohen nga Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave nëpërmjet Sektorit të Trajtimit të Burimeve Pyjore, i cili ua shpërndan Drejtorive të Shërbimit Pyjor, me urdhër me shkrim të drejtorit të Politikave të Pyjeve dhe Kullotave dhe në përputhje me kontratat e lidhura.

3. Certifikata e origjinës për eksport plotësohet në tre kopje, nga seksioni i financë-marketingut dhe seksioni i Administrim-Menaxhimit të pyjeve dhe kullotave dhe firmoset nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, pastaj vuloset. Kopja e parë dhe e tretë i jepet subjektit, kundrejt marrjes së firmës dhe kopja e dytë mbetet në bllok, të cilin e mban seksioni i financë-marketingut në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të rrethit.

4. Në përfundim, për çdo bllok certifikatash hartohet një procesverbal, ku evidentohen të gjitha kopjet e mbetura, sipas numrave të serisë. Procesverbali hartohet dhe firmoset nga seksioni i

financë-marketingut dhe seksioni i administrim-menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Blloku së bashku me procesverbalin depozitohen në arkivën e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor.

5. Regjistrimi i certifikatave të eksportit bëhet në regjistra të veçantë, sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi. Regjistrat e certifikatave të eksportit mbahen nga seksioni i financë-marketingut në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor dhe ruhen për një afat 5-vjeçar.

6. Lëshimi i certifikatës së origjinës për eksport jashtë kërkesave të përcaktuar në këtë udhëzim, ngarkon me përgjegjësi ligjore personin përgjegjës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR

Adresa: _____

Nr. _____ Prot.

....., më _____.2006

Nr. 000000

CERTIFIKATË ORIGJINE PËR EKSPORT
PËR MATERIALET DRUSORE OSE TË PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE E
JOPYJORE, TË PËRPUNUARA OSE TË PAPËRPUNUARA, ME ORIGJINË NGA FONDI
PYJOR E KULLOSOR PUBLIK

Subjektit _____ (emërtimi) _____, kontraktor me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor _____ me numër kontrate _____ datë _____ (N/kontraktor me subjektin _____ me numër kontrate _____ datë _____ (emërtimi) _____, për _____ (shënohet aktiviteti i këtij subjekti, p.sh. shfrytëzim pyjesh, vjelje bimësh etj). _____ me lejen përkatëse nr. _____, datë _____ kontratën e datës _____, i lëshohet kjo certifikatë origjine për eksportin e produktit të poshtëshënuar.

Produkti është prodhuar/vjelë/nxjerrë/grumbulluar/përpunuar dhe paguar konform ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”; ligjit nr.7722, datë 15.06.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Produkti/tet e mëposhtme nuk janë përfshirë në listën e pyjeve dhe të pjesëve të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë, të publikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe në listën e specieve të rrezikuara të Konventës “Për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër” (CITES) dhe si i tillë, lejohet eksporti/tet i tij.

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia matjes	Sasia	
			me shifra	me fjalë
1				
2				
3				

Lista e mësipërme përfundon me numrin rendor ____.

Shënim. Kjo certifikatë shoqërohet me të gjithë dokumentacionin tjetër të nevojshëm për shitjen dhe eksportin e produktit.

P/Seksionit të financës-marketingut

.....

P/Seksionit të administrim- menaxhimit

.....

D R E J T O R I



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR**

Adresa:
Nr. _____ Prot.

....., më _____.2006

Nr.
000000

**CERTIFIKATË ORIGJINE PËR EKSPORT
PËR SPECIE TË FAUNËS SË EGËR, TË NDODHURA NË FONDIN E GJUE TISË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Subjektit _____ (emërtimi) _____, kontraktor me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor _____, me kontratën e datës _____ për zhvillimin e gjuetisë (sportive ose turistike), mbështetur në lejen e gjuetisë nr. _____, datë _____, i lëshohet kjo certifikatë për eksportin e specieve të mëposhtme.

Këto specie janë gjuajtur dhe paguar konform ligjit nr.7875, datë 23.11. 1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”, i ndryshuar, ligjit nr.9219, datë 8.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Ato nuk janë të përfshira në listën e specieve të rrezikuara të Konventës “Për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër” (CITES) dhe si të tilla, lejohet eksporti i tyre.

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia	
			me shifra	me fjalë
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Lista e mësipërme përfundon me numrin rendor ____.

Shënim. Kjo certifikatë shoqërohet me të gjithë dokumentacionin tjetër të nevojshëm për shitjen dhe eksportin e mallit.

Përfaqësues i subjektit _____ është z. _____, me pasaportë nr. _____.

P/seksionit të financës-marketingut
.....

P/ seksionit të administrim- menaxhimit
.....

D R E J T O R I

Modeli i CITES



REPUBLIC OF ALBANIA
Ministry of Environment, Forests and Water Administration

**Convention of International Trade in
Endangered Species of Wild Flora and Fauna**

PERMIT/CERTIFICATE

1. Export	Re-export	Import	Others	2. Valid until	months	
3. Importer (name and address)			4. Exporter (name and address)			
3a. Country of import						
5. Special conditions For the live animals this permit of certificate is valid only when the transport conditions come in conformity with the guidelines of transporting live animals or/in case of air transport, with IATA regulation for the live animals.			6. Name, address, national seal of the Country's Issuing Management Authority			
7/8 Scientific name (Gender and specie) and the common name of the plant or animal		9. Description of specimens. Including identifying marks or numbers (age/sex for the live species)		10. Appendix and the source	11. Quantity (in units)	11a. Total of exported/Quota
A						
B						
C						
10. Country of origin	11. Permit No. 000	Date	12. Country of last re-export	Certificate NO.	Date	12b. No. of action or date of issue
13. This permit is issued by:						
Location Tirana		Date		Security seal, signature and official seal		
14. Export approval Bill of landing/Flight Number						
Block	Quantity	Port of export Date Signature Official seal and title				



REPUBLIKA E SHQIPERISE

CITES KONVENTA PER TREGTINE
LLOJEVE TE RREZIKUARA

No. NDERKOMBETARE TE

CITES LEJE/ ÇERTIFIKAT

FLORES DHE FAUNES SE EGER

.....

1. Eksport	Ri-eksport	Import	Te tjera	2. E vlefshme deri		
3. Importuesi (emri dhe adresa)		4. Eksportuesi (emri dhe adresa)				
3a. Shteti importues						
5. Kushte te vecanta		6. Emri, adresa, vula kombetare e Autoritetit Menaxhues te vendit				
Per kafshet e gjalla, kjo leje ose certificate eshte e vlefshme vetem kur kushtet e transportit jane konform Udhhezimit per transportin e kafsheve te gjalla ose, ne rastin e transportit ajror, me Rregulloren e IATA-s per kafshet e gjalla.						
5a.Q ellimi i transaksionit	5b.Vula e sigurimit					
7./8.Emri shkencor (Gjini dhe specie) dhe emri i perbashket i bimes ose kafshes		9. Pershkrimi i specimeneve, perfshire shenime identifikuese ose numra (mosha/seksi per specie te gjalla)		10. Apendiksi dhe burimi	11. Sasia (perfshire unite)	11a. Totali eksportuar/ Kuota
10. Shteti i origjines	11. Numri i lejes	ata	12. Vendi ri-eksportues i fundit	Certificate Nr.	Data	12b. Nr. i veprimit, ose data e marrjes
13. Kjo leje eshte leshuar nga:						
Vendi _____ Data _____ pulla e sigurise, firma dhe vula zyrtare						
14. Miratimi i eksportit Numri i fluturimit						
Blloku	Sasia					
Porti i eksportit		Data	Firma	Pulla zyrtare dhe titulli		

Nr.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE
DREJTORIA E SHERBIMIT PYJOR

REGJISTRI I ÇERTIFIKATAVE TE ORIGJINES PER EKSPORT

Çertifikata		Emertimi i subjektit	Kontrata		Emertimi i produktit	Njes.m atj.	Sasia	Marresi i certifikates	
Nr.i serise	Date		Nr.	Date				Emri mbiemri	Firma

(PER PRODUKTET NGA FONDI PYJOR E KULLOSOR)

VENDIM
Nr.5, datë 3.3.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Nikoleta Kita	Anëtare
Kristaq Ngjela	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Evjeni Sinojmeri	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 31.01.2006, morën në shqyrtim çështjen civile nr.6 Akti, që i përket:

PADITËS: FEHMI XHEMO, GËZIM SPAHO, GËZIM BEGOLLI, në mungesë.

I PADITUR: KËSHILLI BASHKIAK KORÇË, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Anulimi i aktit administrativ, vendimi nr.51, datë 06.09.2005 i Këshillit të Bashkisë Korçë.

Baza ligjore: Neni 328 i Kodit të Procedurës Administrative, si dhe ligji nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1912, datë 13.10.2005, ka vendosur:

- Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile me palë paditëse Fehmi Xhemo, Gëzim Spaho, Gëzim Begolli, i paditur Këshilli Bashkiak Korçë, me objekt anulimin e aktit administrativ, vendimi nr.51, datë 06.09.2005 i Këshillit të Bashkisë Korçë.

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs paditësit, të cilët kërkojnë trajtimin gjyqësor të çështjes nga gjykata kompetente, duke parashtruar këto shkaqe:

- Konstatimi i gjykatës se ligji nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, nuk parashikon ankim në gjykatë kundër vendimeve që merr këshilli bashkiak, për vendimmarrjet që ai realizon si organ kolegjal, vjen në kundërshtim me nenin 1/2 të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se: *“Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendim për çështjet që i paraqiten për shqyrtim me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërtënie ose është i paqartë”*.

- Vendimi i gjykatës vjen në kundërshtim edhe me nenin 16/1 të Kodit të Procedurës Civile pasi prej kësaj gjykate nuk janë marrë në konsideratë dispozitat ligjore dhe normat në fuqi të legjislacionit shqiptar që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj.

- Duke iu referuar nenit 3 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se organe të administratës publike janë *“... organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative”*. Në këto kushte, pala e paditur Këshilli Bashkiak i Bashkisë Korçë rezulton të jetë organ administrativ ndaj dhe veprimtaria dhe aktet që nxjerrin, në zbatim të nenit 18/b të Kodit të Procedurave Administrative, i nënshtrohen kontrollit nga gjykata në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

- Si Kodi i Procedurave Administrative, ashtu dhe Kodi i Procedurave Civile përcaktojnë se çështja objekt shqyrtimi hyn në kompetencën dhe juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Korçë. Neni 59 i Kodit të Procedurës Civile i jep të drejtë gjykatës në çdo shkallë e fazë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, të marrë në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ.

- Arsytimi i gjykatës është i gabuar, kur pranon se palët interpretojnë në mënyra të ndryshme kompetencën e heqjes së mandatit të këshilltarit të qarkut, dhe se veprimi i gjykatës në këtë rast do të cenonte pavarësinë e ndonjë pushteti tjetër.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke konstatuar se ka disa praktika gjyqësore në këtë drejtim, vendosi në seancë gjyqësore më datë 15.12.2005 të kalojë çështjen për shqyrtim në Kolegje të Bashkuara, me qëllim që të mbahet një qëndrim i unifikuar për këto raste:

a) A duhen konsideruar akte administrative vendimet e këshillave të komunave dhe bashkive, ndër të tjera, edhe për heqjen e mandatit të këshillave komunalë apo bashkiakë në Këshillin e Qarkut. Për këtë referimi më i afërt do të ishin nenet 109 e 110 të Kushtetutës, neni 3 dhe 18/b i Kodit të Procedurave Administrative, si dhe neni 324 i Kodit të Procedurës Civile.

b) A është akt ndaj të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë edhe pse ligji nuk ka një parashikim për këtë por, nga ana tjetër, nuk e ndalon në mënyrë të shprehur. Veç ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, duhet pasur në konsideratë dispozita e nenit 326 germa b e Kodit të Procedurës Civile, si edhe neni 36/1 i këtij Kodi dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, veçanërisht neni 18/b.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Shpresa Beçaj dhe Ardian Dvorani, e pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.1912, datë 13.10.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është i bazuar në ligj, prandaj duhet të lihet në fuqi.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë rezultojnë rrethanat e çështjes si më poshtë:

Me vendimin nr.3, datë 15.12.2003 të Këshillit Bashkiak Korçë, paditësit Fehmi Xhemo, Gëzim Spaho e Gëzim Begolli janë zgjedhur si përfaqësues të këtij këshilli për Këshillin e Qarkut Korçë, në bazë të nenit 26 pika 6 e ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Sipas kësaj dispozite, “6. Në mbledhjen e parë të këshillit komunal ose bashkiak:.. d) zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen ata me mandatin e përfaqësimit”.

Me vendimin nr.51, datë 06.09.2005, Këshilli Bashkiak Korçë ka vendosur t’u heqë paditësve mandatin e përfaqësimit si këshilltarë në Këshillin e Qarkut Korçë duke zgjedhur në vendin e tyre 3 përfaqësues të tjerë, në bazë të nenit 32 germa “i” dhe të nenit 52 pika 3/b të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, sipas të cilit “3. Anëtarit të këshillit të qarkut i mbaron mandati kur: b) mandati i anëtarit hiqet nga këshilli komunal ose bashkiak përkatës: ...”

Paditësit Fehmi Xhemo, Gëzim Spaho e Gëzim Begolli me kërkesëpadi kanë kërkuar anulimin e vendimit nr.51, datë 06.09.2005 të Këshillit Bashkiak Korçë duke parashtruar para Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë se:

- Ata janë zgjedhur ndërmjet të tjerëve si përfaqësues të Këshillit Bashkiak Korçë për në Këshillin e Qarkut Korçë, në bazë të vendimit nr.3, datë 15.12.2003 të Këshillit të Bashkisë Korçë, në mbështetje të nenit 26 pika 6 (d) të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

- Vendimi nr.51, datë 06.09.2005 i Këshillit të Bashkisë Korçë, objekt gjykimi, është marrë në kundërshtim me nenin 32/i të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për shkak se në këtë nën ligjvënësi ka përcaktuar kompetencën e zgjedhjes së përfaqësuesit nga radhët e Këshillit Bashkiak për në Këshillin e Qarkut, por jo të drejtën për t’i shkarkuar ata.

- Neni 52/3 germa “b” i ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 ka të bëjë me heqjen e mandatit të këshilltarit dhe jo të përfaqësuesit në Këshillin e Qarkut.

- Heqja e mandatit të këshilltarit është kompetencë e Këshillit të Qarkut në bazë të nenit 54 germa “k” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000.

- Të drejtën e heqjes së mandatit nuk mund ta ushtrojnë njëkohësisht dy organe vendimmarrëse, pasi heqja e mandatit të këshilltarit është e rregulluar në nenin 27/4 të ligjit nr.8652,

datë 31.07.2000, ndërkohë që vendimi nr.51, datë 06.09.2005 i Këshillit të Bashkisë Korçë nuk bazohet në asnjë prej shkaqeve të përcaktuara në nenin 27/4 të ligjit të mësipërm.

Pala e paditur, Këshilli Bashkiak Korçë ka bërë prapsimet para Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë duke parashtruar se:

- Nga këndvështrimi i rregullt ligjor, Këshilli Bashkiak është ai që zgjedh përfaqësuesit e tij në Këshillin e Qarkut dhe është po ky Këshill Bashkiak që heq mandatin e përfaqësimit të përfaqësuesve të vet për në Këshillin e Qarkut.

- Në asnjë nen të ligjit nuk sanksionohet e drejta e ankimit ndaj një vendimi të tillë siç është ai nr.51, datë 06.09.2000, i marrë nga ana e Këshillit Bashkiak, por dhe në përgjithësi asnjë individ i këshilltar në këshillin përkatës nuk i njihet e drejta e ankimit ndaj vendimmarrjes së këtij organi kolegjal.

- Njohja e një të drejte të tillë do të sillte cenimin e parimit të kolegjalitetit të organit përkatës administrativ dhe cenimin e hapur të vullnetit të shumicës në këtë organ kolegjal. Këto parime gjejnë zbatim në nenet 26/4/7, 27/2, 31/7/8, 33/2/3 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, ku në çdo rast kërkohet shumica.

- Në mbështetje të nenit 14 pika 2 të ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, verifikimi i ligjshmërisë së akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore, në komuna, bashki dhe qark, bëhen nga prefekti pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurat e pikës 3 të këtij neni.

- Në rastin konkret, Prefekti i Qarkut Korçë në ushtrim të kompetencave të tij, është shprehur për bazueshmërinë e tyre ligjore. Fakti që në të dyja ligjet e mësipërme nuk parashikohet asnjë procedurë ankimi dhe as ndjekja e ndonjë procedure tjetër administrative, tregon se si ligji specifik, ashtu edhe ai procedural nuk lejon ankimin e pakicës kundër vendimit të shumicës brenda të njëjtë organ kolegjal. Në rast se kjo do të ishte e lejuar, ligjet duhet të shpreheshin në mënyrë të posaçme për këtë aspekt.

*

*

*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se mbarimi i mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut për shkak të heqjes së tij nga këshilli bashkiak përkatës, bazuar në nenin 52/3 (b) të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nuk përbën lëndë për shqyrtimin e konfliktit në rrugë gjyqësore.

Si vendimet e këshillit bashkiak për zgjedhjen e anëtarëve që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe për pajisjen e tyre me mandatin e përfaqësimit në këtë këshill, ashtu edhe vendimet e këshillit bashkiak për heqjen e mandatit të përfaqësimit në këshillin e qarkut, nga natyra e tyre janë akte administrative individuale, sepse janë nxjerrë nga një organ i administratës publike, në kuptim të nenit 113(d) të Kushtetutës dhe të nenit 3 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të nenit 105 të këtij kodi.

Sipas nenit 3, “Në kuptim të këtij kodi, organe të administratës publike janë: ...

- organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative; ...”, ndërsa sipas nenit 105, “Për qëllimet e këtij ligji, do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale.”

Megjithatë, vendimet e këshillave bashkiakë apo komunalë për zgjedhjen e anëtarëve që do t'i përfaqësojnë në këshillin e qarkut dhe ato për heqjen e mandatit të përfaqësimit në këtë këshill konsiderohen akte administrative individuale të një natyre të veçantë, sepse ato nuk janë akte që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike me të tretët, por akte që rregullojnë konstituimin, organizimin dhe funksionimin e brendshëm të këshillit të qarkut në bazë të rregullit të përfaqësimit përpjestimor të subjekteve politike, të zgjedhurit e të cilave kanë konstituuar këshillin bashkiak apo komunal përkatës.

Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nuk ka parashikuar rrugën gjyqësore të ankimit kundër këtyre akteve administrative. Kjo është në harmoni me kërkesat e nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, “Nuk mund të ngrihet padi në gjykatë për:

.....

b) akte administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë.

.....”.

Është e vërtetë që ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nuk ka një parashikim të shprehur nëse subjektet që preken nga këto akte administrative mund të bëjnë ankim në gjykatë dhe, nga ana tjetër, ky ligj nuk përmban gjithashtu një ndalim të shprehur për aksesin në gjykatë. Ky pohim, i marrë i shkëputur, do të çonte në përfundimin e pranimit të ankimit në rrugë gjyqësore të këtyre akteve administrative, sipas rregullit të përgjithshëm që askujt nuk mund t’i mohohet mbrojtja gjyqësore e një të drejte që pretendohet se i është shkelur, mohuar apo cenuar.

Mirëpo, neni 18/b i Kodit të Procedurave Administrative, përsa i përket kuptimit dhe zbatimit të parimit të kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë së veprimtarisë administrative, të referon në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, “Në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave privatë, veprimtaria administrative i nënshtrohet:

.....

b) kontrollit nga gjykatat në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.

Ky referim të çon në dispozitat e kreut të II (gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative) të këtij Kodi (nenet 324 e vijues). Ndërsa rregulli i përgjithshëm pranon rrugën gjyqësore të kundërshtimit të akteve administrative, neni 326 parashikon rastet përjashtimore, në të cilat ndalohej aksesin në gjykatë, siç është edhe rasti i parashikuar në pikën “b” të kësaj dispozite të cituar më lart.

Siç jemi shprehur më lart, vendimet e këshillit bashkiak (komunal) për zgjedhjen apo shkarkimin e anëtarëve që përfaqësojnë këtë këshill në këshillin e qarkut, si akte administrative individuale të një natyre të veçantë, kanë rregullim ligjor të posaçëm, sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë.

Në këndvështrimin e shumicës së anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk vërehet ndonjë kontradiktë midis përmbajtjes së nenit 18 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile. Të zgjedhurve si përfaqësues në Këshillin e qarkut nëpërmjet shkarkimit nga kjo detyrë në zbatim të kriterëve të parashikuara në ligjin për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore, nuk u shkelet ndonjë e drejtë kushtetuese apo e drejtë e mbrojtur me ligj. Nga ana tjetër, **këta persona të zgjedhur nuk konsiderohen persona privatë e nuk përfitojnë të drejta si të tillë, por ata janë funksionarë publikë, veprimtaria e të cilëve i nënshtrohet një regjimi juridik të posaçëm, i cili përjashton rrugën gjyqësore të shqyrtimit të konflikteve të lindura gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.**

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në bazë të nenit 326/b të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 17 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”,

VENDOSËN:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.1912, datë 13.10.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
- Ky vendim për njësim të praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët në pakicë, ndryshe nga qëndrimi i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, jemi të mendimit se vendimi nr.1912, datë 13.10.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja civile me palë paditëse Fehmi Xhemo, Gëzim Spaho e Gëzim Begolli dhe të paditur Këshillin Bashkiak Korçë, me objekt anulimin e vendimit nr.51, datë 06.09.2005 të të paditurit, është një vendim gjyqësor i pambështetur në ligj, prandaj ai duhet të prishej dhe çështja t’i dërgohej po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Nga aktet e ndodhura në dosje, rezulton se paditësit, me vendimin nr.3, datë 15.12.2003 të

Këshillit Bashkiak të Korçës, në mbledhjen e parë të tij, janë zgjedhur si përfaqësues në Këshillin e Qarkut të Korçës. Në përmbushje të procedurave ligjore, në mbledhjen e parë të Këshillit të Qarkut, ndërmjet të tjerave, është bërë vërtetimi i mandateve të këshilltarëve të qarkut dhe në përfundim, edhe konstituimi i Këshillit të Qarkut të Korçës.

Me vendimin nr.51, datë 06.09.2005, i padituri, Këshilli Bashkiak Korçë, ka vendosur t'u heqë paditësve mandatin e Këshilltarit në Këshillin e Qarkut të Korçës, duke zgjedhur në vend të tyre tre përfaqësues të tjerë. Këtë vendim ana e paditur e ka mbështetur në nenin 52 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Paditësit, duke kundërshtuar këtë vendim, kanë ngritur padi për anulimin e tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjykata ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me arsyetimin se ligji nr.8652, datë 31.07.2000 nuk parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimeve të kësaj natyre të nxjerra nga këshillat bashkiakë. Kundër këtij vendimi gjyqësor ka bërë ankim ana paditëse dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka dërguar çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.1912, datë 13.10.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Shumica e ka mbështetur qëndrimin e mësipërm në arsyetimin se paditësve nuk u është shkelur ndonjë e drejtë kushtetuese, apo e mbrojtur me ligj. Sipas shumicës, vendimi i anës së paditur për heqjen e mandateve të paditësve, është akt administrativ individual, i një natyre të veçantë, që lidhet me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të këshillit të qarkut. Duke qenë funksionarë publikë, veprimtaria e paditësve i nënshtrohet një regjimi juridik të posaçëm, i cili përjashton rrugën gjyqësore të shqyrtimit të konfliktit të lindur ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Pakica ka mendimin se, në rastin e çështjes civile objekt gjykimi, nuk jemi përpara rasteve të parashikuara në nenin 326 shkronja "b" të Kodit të Procedurës Civile, në të cilat nuk lejohet ankimi në gjykatë i aktit administrativ për emërimin a shkarkimin e funksionarëve publikë. Gjithashtu, pakica është e mendimit se, mungesa e një norme të shprehur në ligjin e posaçëm, ligjin nr.8652, datë 31.07.2000, lidhur me të drejtën e ankimit të paditësve në gjykatë kundër aktit administrativ të nxjerrë nga ana e paditur, nuk përjashton të drejtën e tyre për t'iu drejtuar me padi gjykatës për të shqyrtuar një mosmarrëveshje administrative, pra juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.

Qëndrimin e saj pakica e mbështetet në dispozitat e Kushtetutës, në norma të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit të posaçëm, sikurse është ligji nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Në nenin 6 të Kushtetutës parashikohet se organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara prej saj rregullohet me ligje të posaçme, të nxjerra në bazë e për zbatim të saj. Nga ana tjetër, në nenin 116 të saj Kushtetuta parashikon se, pas saj, në hierarkinë e akteve normative vijnë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Sipas nenit 122 këto marrëveshje janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohen direkt, përveç kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji (sistemi monist). Nëse është nxjerrë ky ligj, përsëri Kushtetuta sanksionon epërsinë e normës ndërkombëtare nëse ligji bie ndesh me të.

Në pjesën e gjashtë të Kushtetutës parashikohen norma të posaçme lidhur me qeverisjen vendore. Kështu në nenin 108 pika 1 parashikohet se njësi të qeverisjes vendore janë komunat, bashkitë dhe qarqet. Në vijim, pika 4 e këtij neni përcakton se *vetëqeverisja* në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese, të cilat janë *këshillat*. Sipas nenit 110 në përbërje të këshillit të qarkut janë edhe *anëtarë të tjerë të zgjedhur* me lista përpjestimore nga këshilltarët bashkiakë ose komunalë të njësive që përbëjnë qarkun. Jo vetëm neni 108, por edhe nenet 111-113 nuk e vendosin qarkun dhe këshillin e tij në një pozitë kushtetuese të ndryshme apo vartësie nga dy njësitë e tjera bazë të qeverisjes vendore: bashkitë dhe komunat. Të gjitha këto njësi vendore kanë mision, kompetenca dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore për t'i ushtruar nëpërmjet vetëqeverisjes dhe në mënyrë të pavarur nga pushteti qendror, apo nga njëra-tjetra.

Me ligjin nr.8548, datë 11.11.1999 është ratifikuar "Karta Europiane e Autonomisë Vendore" (Karta) pa ndonjë deklaram apo rezervë të Republikës së Shqipërisë. Sipas kësaj Karte, gjë që reflektohet në frymën dhe normat e Kushtetutës sonë, njësitë vendore duhet të ushtrojnë përgjegjësi efektive, duke qenë të mbrojtura në ushtrimin e autonomisë vendore nga ndërhyrja e pushtetit qendror apo organe të tjera të qeverisjes vendore. *Neni 7/1 i Kartës parashikon se statusi i të zgjedhurve*

*vendorë duhet të sigurojë ushtrimin e lirë të mandatit të tyre. Karta e përcakton këtë normë si vendimtare për ekzistencën e qeverisjes vendore dhe kjo gjen pasqyrim në nenin 12, ku palët e saj detyrohen të jenë të lidhura me zbatimin e nenit 7/1 të Kartës. Në nenin 13 parashikohet se *parimet e Kartës gjejnë zbatim për të gjitha kategoritë e bashkësive vendore.**

Pakica ka mendimin se jo vetëm në zbatim të pjesës së gjashtë të Kushtetutes sonë, por edhe të nenit 7/1 e vijues të Kartës, funksionimi normal i qeverisjes vendore, si dhe ushtrimi i lirë i mandatit të këshilltarëve të çdo lloji njësie vendore, do të cenohej rëndë nëse ata nuk do të kishin të drejtë ankimi kundër vendimeve të këshillave të organeve vendore për t'u hequr atyre, mbi çfarëdo motivi, mandatin e anëtarit të këshillit.

Mandati i këshilltarit buron dhe fitohet nga zgjedhjet vendore. Maxhorancat politike që krijohen në këshilla janë rrjedhojë e rezultatit të këtyre zgjedhjeve. Por, sipas mendimit të gjyqtarëve të pakicës, maxhorancat apo minorancat politike në këshillat vendorë, nuk mund të heqin apo cenojnë *ushtrimin e lirë të mandatit të këshilltarit*, pas momentit të konstituimit të këshillit komunal a bashkiak, si dhe atij të qarkut. Përrjashtim bëjnë vetëm rastet e papajtueshmërive dhe të disa shkeljeve faktike ligjore të parashikuara në mënyrë të shprehur nga ligji, përfshirë ligjin nr.8652, datë 31.07.2000.

Vendimet e këshillit bashkiak a komunal, përfshirë edhe ato për miratimin apo heqjen e mandatit të këshilltarëve të tyre ose në këshillin e qarkut, janë akte administrative individuale. Por mungesa e një norme të shprehur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000, për të drejtën e ankimit ndaj një vendimi të tillë nuk mund të shërbejë si argument, mbi të cilën mbështetet edhe qëndrimi i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara, për të konkluduar se mungon juridiksioni gjyqësor në shqyrtimin e mosmarrëveshjes civile (administrative) për heqjen e mandatit të këshilltarit.

Pakica është e mendimit se, në kushtet kur Kushtetuta apo ligji i veçantë nuk parashikojnë shprehimisht një mënyrë të posaçme ankimi apo nuk e ndalojnë shprehimisht ankimin në rrugë gjyqësore, alternativa këto që janë të parashikuara nga legjislacioni ynë i posaçëm për disa kategori të tjera funksionarësh publikë, atëherë, ndaj akteve administrative individuale, qoftë edhe për emërimin e shkarkimin e funksionarit publik, mund të bëhet ankim në gjykatë në rrugën e zakonshme. Qëndrimi i gjyqtarëve të pakicës është se këshilltarët e njësive të qeverisjes vendore nuk përfshihen në rastet e parashikuara në nenin 326, shkronja "b" të Kodit të Procedurës Civile, pra nuk ndodhemi përpara rastit të aktit administrativ me "rregullim ligjor të posaçëm" lidhur me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë.

Në çështjen në gjykim, mungesa e një norme të shprehur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000, lidhur me të drejtën e ankimit të këshilltarit ndaj vendimit të këshillit bashkiak për heqjen e mandatit të tij, nuk mund të interpretohet se nuk ekziston një e drejtë e tillë ankimi për heqjen e mandatit të këshilltarit, lidhur me motivin dhe procedurën-ligjore ku ai vendim është mbështetur. Nëse do të pranohej një interpretim i tillë i Kushtetutes dhe i ligjit, pakica është e mendimit se mandati i këshilltarit është i pagarrantuar, pra nuk është "*i lirë*" dhe, në këtë mënyrë, edhe vetë funksionimi kushtetues, normal, i njësive vendore.

Pakica konstaton se, nga shqyrtimi i përmbajtjes së dispozitave të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, mungesa e së drejtës së ankimit ndaj heqjes së mandatit të këshilltarit, nuk është vetëm për këshilltarët e qarkut, por edhe për ata të komunës dhe bashkisë. Në rrethana të tilla, gjyqtarët e pakicës janë të mendimit se qëndrimi është dhe duhet të jetë i njëjtë për të tre kategoritë e këshilltarëve, pavarësisht nga motivet dhe rastet kur këshilli komunal a bashkiak merr vendim për heqjen e mandatit të një këshilltari.

Rasti i këshilltarëve të njësive vendore nuk përfshihet në nenin 326 shkronja "b" të Kodit të Procedurës Civile, edhe pse ata përfshihen, në kuptimin e gjerë, në kategorinë e funksionarëve publikë. Por këshilltarët, sikurse disa kategori funksionarësh të organeve të tjera kushtetuese nuk janë funksionarë publikë të zakonshëm. Misioni, përgjegjësitë dhe garancitë për ushtrimin e mandatit të tyre janë të posaçme. Kjo gjendje kushtetuese dhe ligjore e posaçme rrjedh nga normat kushtetuese të sipërcituara, gje që në mungesë, paqartësi, etj. të normës së shkruar në ligj, bën të zbatueshëm parimin themelor të procedurës civile të parashikuar në nenin 1, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "gjykata nuk mund të refuzojë, të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë".

Sikurse edhe për funksionarë të tjerë publikë që kanë mandat "politik", edhe në rastin e këshilltarëve të njësive vendore, dhënia dhe heqja e këtij mandati, rastet dhe procedurat e heqjes së tij,

mjetet e ankimit, janë të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë ose duhet të jenë të tilla në ligje të veçanta. Nëse ligji nuk i parashikon shprehimisht ato, rrugën administrative apo gjyqësore të ankimit, gjejnë zbatim parimet e përgjithshme kushtetuese dhe ligjore të organizimit dhe funksionimit të institucioneve, pra edhe të organeve administrative. Ankimimi në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor nuk do të ishte i mundur vetëm nëse Kushtetuta e ka parashikuar atë shprehimisht ndryshe, apo ligjet e nxjerra në zbatim të saj kanë ndaluar shprehimisht të drejtën e ankimit në tërësi, apo në raste të veçanta.

Gjithashtu, në gjykimin e kësaj çështjeje, pakica ka mendimin se lidhur me të drejtën e ankimit të këshilltarit të qarkut ndaj vendimit të këshillit bashkiak për heqjen e këtij mandati, thelbësore nuk është natyra, forma e këtij vendimi, cilësimi si akt administrativ, individual ose jo. Thelbësore është bazueshmëria kushtetuese dhe, më pas ligjore, e vendimmarrjes së këshillit bashkiak, për t'i hequr mandatin si këshilltar qarku disa anëtarëve të tij të zgjedhur në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, është garantimi i ushtrimit të lirë, i mbrojtjes së mandatit të këshilltarit, si dhe mjetet përkatëse për realizimin efektiv të kësaj mbrojtjeje, përfshirë edhe rrugën gjyqësore.

Nga shqyrtimi i dispozitave të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 rezulton se ai parashikon raste konkrete të heqjes së mandatit të këshilltarit, të cilat nuk lidhen me motive politike, por me gjendje faktike që ligjvënësi i ka çmuar si raste që mund të motivojnë mbarimin para kohë, heqjen e mandatit të këshilltarit. Parashikimi në ligj i marrjes së vendimit për heqjen e mandatit me shumicën e anëtarëve të këshillit bashkiak a komunal, nuk përbën në vetvete garanci se ky organ kolegjal, shumica e tij, e kanë mbështetur vendimin në procedurat dhe rastet e treguara nga ligji. Nëse nuk do të pranohej ekzistenca e një mjeti ligjor për riparimin e situatës së mundshme të shkeljes së ligjit në vendimin e marrë nga organi kolegjal administrativ, përfshirë rrugën gjyqësore, kjo do të përbënte një qëndrim që bie ndesh me frymën dhe dispozitat kushtetuese e ligjore.

Nga ana tjetër, formimi i një shumice në vendimmarrje të organit kolegjal nuk përbën në vetvete garanci për dhënien e një vendimi të mbështetur në ligj, për ushtrimin e lirë të mandatit të këshilltarit dhe për respektimin e vullnetit të zgjedhësve, që përbën burimin e vetëm të zgjedhjes dhe fitimit të mandatit të këshilltarit të këtyre organeve të njëjësive vendore.

Ndryshe nga shumica, qëndrimi i gjyqtarëve në pakicë është se, në kuptim të nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile, shprehja "rregullim ligjor të posaçëm" do të interpretohej si një rast kur ankimi bëhet në mënyrë të posaçme, me rrugë dhe mjete ankimi të veçanta, përpara organeve të posaçme dhe jo në shkallët e zakonshme administrative a gjyqësore të ankimit, ose si një rast kur është parashikuar shprehimisht mungesa e një të drejte të tillë, ose si një rrugë ankimimi jashtë pushtetit gjyqësor, p.sh. në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa për funksionarët e tjerë publikë, nëse ligji nuk ndalon shprehimisht të drejtën e ankimit në gjykatë, apo nuk përmban një normë tjetër të shprehur, duhet të zbatohet parimi i përgjithshëm mbi të drejtën e ankimit në rrugën e zakonshme gjyqësore.

Përfundimisht, pakica ka mendimin se përsa u argumentua më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të vendosnin prishjen e vendimit nr.1912, datë 13.10.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja civile objekt i këtij gjykimi, si vendim gjyqësor i pambështetur në ligj, duke i dërguar aktet po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimin.

Artan Hoxha, Perikli Zaharia. Agron A. Lamaj, Besnik Imeraj, Shpresa Beçaj, Ardian Dvorani

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 30.5.2006
Doli nga shtypi më 2.6.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë